



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Kuvendi i Komunës Rahovec*

*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNËS/KABINET PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 2486 Nr. i faq./Br.str./No.pg 20  
Data/Datum/Date 22 / 7 / 22  
RAHOVEC / ORAHOVAC

# PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT BUXHETIN E VITIT 2023

## INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025, u publikua me datë: 10.06.2022 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-KONSULTIM-PUBLIK-SHQIP.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

Njoftimi përveç që është publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rjetin social Facebook, njoftimi u është dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

## KONSULTIMI PUBLIK

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, Udhëzim Administrativ ky që ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga ana e autoriteteve lokale të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, të promovoj transparencë komunale, si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm, Kuvendi Komunal i Rahovecit, respektivisht Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa mbajtën konsultimin publik për projekt buxhetin e vitit 2023.

Konsultimi publik filloi në orën: 10: 00

Konsultimin e kryesuan:

- Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu, dhe
- Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani

Nga radhët e Komitetit për Politikë dhe Financa ishin prezent:

1. Burim Krasniqi,
2. Besmira Bytyqi,
3. Melinda Iska.

Të pranishëm në konsultim ishin dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim ishte: 18

Numri i femrave pjesëmarrëse ishte: 3

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në konsultim.

BLERTA GASHI

2

Konsultimin e shpalli të hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Defrim Kafexhiu.

**Defrim Kafexhiu, kryesues i Kuvendit Komunal Rahovec:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit, të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani, të nderuar të pranishëm. Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017 si dhe nenit 6 pika 1.2 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit në bashkëpunim me Zyrën për Informim ftoi Konsultimin Publik për Projekt Buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in 2023-2025. Kisha dashur pak me diskutu rëndësinë e pjesëmarrjes në këto dëgjime buxhetore edhe pse pjesëmarrja jo gjithëherë është e kënaqshme kur kemi parasysh se qytetaria active është vlerë e shtuar e një shoqërie, me pjesëmarrjen në këto dëgjime ne krijojmë rolin tone në pjesëmarrjen tonë në vendimarrje nëpër institucione lokale. Kuvendi Komunal krijon një organ i cili quhet Komiteti për Politikë dhe Financa, në të cilin secili grup i partive politike në Kuvendin Komunal delegon në këtë komitet. Këtu jemi katër anëtarë prej gjithsej 7 anëtarëve: kemi Melinda Oruçi-Iska nga PDK, Besmira Bytyqi nga AAK, Burim Krasniqi-LDK dhe unë Defrim Kafexhiu nga VV si kryesues i komitetit. Pa dashur ta zgjas më shumë, nëse dikush prej anëtarëve ka diçka të shtoj rreth konsultimin public, po patjetër Burim Krasniqi:

**Burim Krasniqi:** Faleminderit! I nderuar kryesues, anëtarë të KPF-së, i nderuar drejtor, ju të pranishëm! Pe shoh dhe tash edhe i kam përcjell edhe në të kaluarën që kur takimet i thërret Kuvendi ka më pak pjesëmarrës, kurse kur i thërret kryetari i Komunës është ndryshe. Është dashur me përcjell një mesazh më të qartë te qytetarët që buxhetin e Komunës së Rahovecit e voton asambleja komunale, pra, duhet mbështjettja e asambleistëve për me kalu një buxhet dhe si e tillë në këtë takim që organizon asambleja komunale është dashur me qenë një presence më e madhe e qytetarëve, ose një gjithëpërfshirje më e madhe, ku i kishin shpreh kërkesat dhe nevojat që i kanë nëpër lokalitetet e tyre, qoftë kryetarët e fshatrave që përfaqësojnë zyrtarisht secilin lokalitet, qoftë edhe qytetarët tjerë që kanë shqetësimet dhe nevojat e tyre në përgjithësi. Pjesa tjetër që po du me diskutu është që drejtori i financave në diskutimet a kaluara, por edhe tash kish qenë e udhës për me tregu për mundësitë buxhetore reale që i ka Komuna e Rahovecit, po flas që ka një tavan buxhetor nëpër të gjitha ndarjet buxhetore, për çdo projekt që i ka ardh nga qarkoret buxhetore, në 2023 dhe në orientimet për 2024-2025, dhe si e tillë me paraqit obligimet që ka, kontratat, marrëveshjet, vështirësitë që ka me pas pas rritjes së çmimeve, që ka ndodh pas krizës globale që është fenomen natyror, e që nuk varen as nga kryetari as nga drejtori, dhe me qenë realist, që këto janë mundësitë buxhetore, me i dhonë prioritetet, unë po besoj që ekzekutivi i komunës i ka prioritetet e veta prej fushatës zgjedhore por edhe orientimet zhvillimore që i ka, sepse tek e fundit me atë program i ka marrë votat edhe i dhonë prioritet sipas lokaliteteve, sipas mundësive dhe sipas nevojave, ka dikush nevojë për ujë të pijshëm, për kanalizim, por, ka dikush dhe nevojë për drita, me i kategorizuar nevojat që ata kanë, edhe i thonë kaq kemi mundësi, kaq kemi me bo, edhe për këtë vit, diku mundemi me investu, diku jo sipas mundësive buxhetore që i kemi dhe me qenë edhe ma korrekt edhe me asamblenë edhe me qytetarët edhe në raport me seancën e rregullt të buxhetit kur vjen puna me miratu edhe mos me pas mundësi me debatue kot, sepse mundësitë buxhetore nuk janë llastik që mundesh me e zgjat, këto janë pare që janë, nuk mundemi me dal jashtë këtyre. Unë po besoj që këto i keni sqarue me kryetarin dhe me drejtorin në takimet që i keni pas, edhe po besoj që edhe kryetari edhe drejtori kanë

me i përcjell kërkesat që ju i keni pas, e po besoj që edhe sot do të parashtroni ndonjë nga ato kërkesa që ju keni dhe ne si asamble komunale kur vjen puna te votimi mos me bo politikë te buxheti, por, me i pamundësitë dhe nevojat e qytetarëve ku janë realisht, me ecë aq sa ka mundësi dhe aq sa lejon, unë po shpresoj në mirëkuptimin e secilit dhe po pres nga Zyra për Informim e Komunës së Rahovecit, me informu drejt që roli kyq i votimit të buxhetit është në asambleenë komunale, me marrë pjesë në mënyrë dinjitoze sepse kur asambleisti qon dorën të jetë i bindut që do të votoj drejt. Faleminderit shumë!

**Defrim Kafexhiu-** Faleminderit Burim! Dikush tjetër prej anëtarëve të KPF-së? Atëherë pa humbur kohë ftoj drejtorin e financave, të cilin e ftoj që të na paraqes në pika të shkurtëra ndarjet buxhetore.

**Afrim Limani drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, faleminderit për pjesëmarrje! Në cilësinë e drejtorit për financa me lejoni tju shpjegoj për buxhetin e komunës së Rahovecit për vitin 2023 dhe KAB-in komunal 2023-2025. Diku ka muaji maj vjen një document në adresë të Komunës nga ministria e Financave që ne e quajmë qarkore buxhetore. Në këtë dokument, janë të përcaktuara limitet ose tavanet buxhetore për komunën e Rahovecit dhe organizatat tjera buxhetore sipas limiteve buxhetore, caktohet shuma sa a takon neve për vitin 2023, pastaj ky dokument nëpër faza tjera diskutohet nëpër takime të ndryshme si ky i sotit dhe aty caktohen kërkesat e secilit vendbanim dhe secilit qytetari kështu që në fund të shtatorit është afati ligjor kur ky dokument të merr versionin final dhe pritet të votohet nga ana e asamblesë komunale dhe zyrtarizohet si dokument. Të nderuar ju njoftoj që buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2023 do të jetë 17,548,240.00 Euro.

Buxheti ndahet në disa kategori si:

|                               |              |
|-------------------------------|--------------|
| • Pagat dhe Mëditjet          | 8.458.000.00 |
| • Mallrat dhe Shërbimet       | 2.203.000.00 |
| • Shpenzimet Komunale         | 370.000.00   |
| • Subvencionet dhe Transferet | 820.000.00   |
| • Shpenzimet Kapitale         | 5.701.000.00 |

Pra, ajo që juve ju intereson më së shumti është pjesa e investimeve kapitale, që për vitin 2023 do të jetë një shumë prej 5.701.000.00 euro, nëse e marrim si vlerë duket si shumë e madhe, por, nëse e krahasojmë me nevojat që ka Komuna e Rahovecit, veç qyteti sa ka kërkesa edhe dy herë kjo shumë nuk mund ta mbulojë, mos te flasim për vendbanimet e tjera. Buxheti për vitin 2023 është rritur për 2,494,580 euro, ka rritje në të gjitha kategoritë. Pjesa e grantit dhe pjesa e të hyrave vetanake, që janë nga të hyrat e tatimeve të qytetarëve, ose më saktë nga tatami në prone. Unë më shumë nuk kam çka me shtu, po jau la juve fjalën nëse keni diçka për buxhetin dhe KAB-in komunal. Ju faleminderit!

**Defrim Kafexhiu**— atëherë e hap diskutimin, kushdo që ka ndonjë kërkesë ose sugjerim rreth buxhetit urdhëroni, qoftë edhe për projektet, kërkesat e ndryshme prej vendbanimeve ku vini.

**Adrian Sharku**-Përshëndetje, jam Adrian Sharku, përfaqësues i organizatës GRAPELAND. Projekti Grapeland u punua para 3 viteve saktësisht edhe deri tash nuk kemi marrë asnjë përgjigje se a do të vazhdojë apo jo, kemi shumë pyetje nga qytetarët dhe arsyeja e pjesëmarrjes sonë këtu është a po e jetësojmë Grapelandin a dojmë me e qit në buxhetin e vitit 2023.

**Defrim Kafexhiu**- Faleminderit Adrian, a ka dikush tjetër që dëshiron me marrë fjalën?

**Mirsad Qehaja**, përfaqësues i fshatit Retijë e Ulët: Përshëndetje për juve kryesues, drejtor dhe ju pjesëmarrës. Kërkesat tona janë të njohura edhe për ju sepse disa here i kemi sjellë para jush, por do ti përmend. E para çka më intereson është ndërtimi i fushës sportive, ka fillu diku ka shkurti, në mars është ndërpre, informata që kemi nga kryetari është rritje e çmimeve, tjetra është ndërtimi i fushës sportive që ka mbet nga 2020, vitin e kaluar ka qenë operatori bashkë me drejtorin dhe nga viti i kaluar më nuk janë duk, kemi kërkuar shtrimin e disa metrave shtesë, por për fillimin e punimeve nuk na dhanë asnjë datë. Një nga arsyetimet e kryetarit ishte që ka qellu operatori i dobët, nuk e di qysh i ndajnë operatorët apo sa e kanë afatin kohor, ka dy vite që u tenderu por që nuk ka fillu ende. Tjetër e kemi një konfirmim nga drejtori i shërbimeve publike, për ndriçim publik, kemi vetëm konfirmim asgjë konkrete, ka thënë më vonë tash sa është ajo më vonë a është për vitin kalendarik apo për mandatin tjetër se di.

**Kërkesat që i ka në nevojë fshati Retijë të Ulët:**

- Mermetimi i objektit të shkollës,
- Parku në hyrje të fshatit,
- Mirëmbajtja e rrugës gjatë sezonit veror,
- Kubëzimi i rrugëve afro 700-800 metra.

- Ngjyrosjen e murit te varrezat,
- Pastrimi i gropes skeptike,
- Transporti i nxënësve për Piranë.

**Defrim Kafexhiu-** Faleminderit Mirsad, veç desha dhe një informacion rreth formatit të këtyre dëgjimeve, krahas kryetarit që mban dëgjime buxhetore, sipas legjislacionit edhe Komiteti për Politikë dhe Financa mban dëgjime për përgatitjen e buxhetit sepse asambleja komunale e voton buxhetin komunal dhe kështu këto dëgjime mbahen në mënyrë monitorohet edhe puna e ekzekutivit sa i përket përgatitjes së buxhetit. Faleminderit për këto kërkesa, a ka dhe dikush tjetër të shtoj dicka rreth këtij konsultimi.

**Murat Kryeziu kryetar i këshillit të fshatit Xerxë**– Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kam një pyetje Shkolla e Xërxës, është ndërtim i ri, a është ndarë buxhet dhe sa është ndarë për vitin 2023 dhe nëse është bërë projekti me kë është konsultu projektuesi dhe me çfarë propozime u bë ky projekt sepse është shumë i papranueshëm për fshatin Xerxë.

**Defrim Kafexhiu-** Faleminderit, dikush tjetër? Atëherë ju faleminderit shumë për pjesëmarrje. Pas këtij konsultimi do të përgatitet dhe procesverbali dhe gjitha kërkesat do të evindentohen pastaj do të shqyrtohen se a do të futen në buxhet ose jo.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 11:00



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Malishevës  
Opština Grahovo / Municipality Rahovec

KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT BUXHITIN K KOMUNIT

| Nr. | Mbiemri | Partia           | Nr. Tel     | Niveli |
|-----|---------|------------------|-------------|--------|
| 1   | Rehman  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 2   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 3   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 4   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 5   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 6   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 7   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 8   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 9   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 10  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 11  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 12  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 13  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 14  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 15  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 16  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 17  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 18  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 19  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 20  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |

Blerta Gashi  
Blerta Gashi

Data 24.06.2022

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Malishevës  
Opština Grahovo / Municipality Rahovec

KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT BUXHITIN K KOMUNIT

| Nr. | Mbiemri | Partia           | Nr. Tel     | Niveli |
|-----|---------|------------------|-------------|--------|
| 1   | Rehman  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 2   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 3   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 4   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 5   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 6   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 7   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 8   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 9   | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 10  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 11  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 12  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 13  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 14  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 15  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 16  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 17  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 18  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 19  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |
| 20  | Shahin  | Partia e Pavarur | 069 666 347 | 1      |

Blerta Gashi  
Blerta Gashi

Data 24.06.2022

BLERTA GASHI

Dokumentin e procesverbalit e punës:

**Blerta Gashi**



Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike



Rahovec,  
korrik 2022

**BLERTA GASHI**